

EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6191
E martë, 15 dhjetor 2020
çmimi 0.40 €

Finalizohet projektligji që i jep kompetenca AKK-së për parandalim të korrupsionit | FAQE 7



FLET PËR "EPOKËN E RE" KOMANDANTI I FSK-SË, RRAHMAN RAMA

PLANI I TRANZICIONIT TË FSK-së PO ZBATOHET ME PARAMETRA POZITIVË



Në dyvjetorin e zyrtarizimit të mandatit ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), komandanti i kësaj force, gjeneral Rrahman Rama, ka thënë se është bërë punë e madhe në planin e tranzicionit. Në këtë intervistë dhënë për gazeten "Epoka e re", ai ka thënë se përkéto dy vjet ka parametra pozitivë

për ecurinë dhe zhvillimin e FSK-së. Gjeneral Rama ka thënë se i kanë tejkaluar pritshmëritë sa i përket realizimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së. Ai ka treguar se faza e parë e tranzicionit të FSK-së pritet të përbyllët në fillim të vitit të ardhshëm, përfunduar pastaj me fazën e

e dytë të tranzacionit që, sipas tij, është më sfiduese dhe më komplekse. "Në këtë fazë do ta fillojmë ngritjen e kapaciteteve me mandat dhe mision të ri duke u bazuar në ligje dhe në obligimet tona kushtetuese për mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit të vendit", ka thënë Rama



Partitë politike në Kosovë ende nuk po arrijnë pajtim për një marrëveshje përmes prej paralajmërimeve përmes një tryezë në të cilën do të diskutohej zgjedhja e presidentit të

HOTI: NËSE S'DO TË KETË ZGJIDHJE PËR PRESIDENTIN, TË SHKOJMË NË ZGJEDHJE | FAQE 3

ri. Deri më tanë më shumë ka deklarata nga të gjitha partitë politike përmes opzionin që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Kryeministri Avdullah Hoti ka përsëritur sërisht të hënën se nëse

nuk do të ketë zgjedhje përmes emrin e presidentit të ri, vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Duke e parë këtë situatë rrëth kësaj çështje, analistët politikë u kanë bërë thirrje partive politike përmes reflektimit



PDK-ja: QEVARIA DËSHTOI ME ARSIMIN GJATË PANDEMISË | FAQE 7

RENOVA
PUTZ
Makedoni Xheqci - Tetovë Curë - Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755 Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
 [facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)



OPINION

KUSH I VRAU CIVILËT NË KOSOVË DHE SI U PËRGATITËN LISTAT E CIVILËVE TË VRARË QË I VISHEN UÇK-së? | FAQE 11



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

AKTUALE

GJYKATA SPECIALE KONFIRMON AKTAKUZËN KUNDËR GUCATIT DHE HARADINAJT | FAQE 6

BULLIQI ZGJEDH DREJTORËT E RINJ | FAQE 11

EKONOMI

LANSOHET PAKOJA E RIMËKËMBJES EKONOMIKE NGA FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE | FAQE 9

REÇICA: AFTËSIMI PROFESIONAL, ÇELËS PËR ZBUTJEN E PAPUNËSISË | FAQE 8



SPORT

'NXEHËT' SUPERLIGA, DRITA NDALET NGA ARBËRIA | FAQE 12



Emiratet e Bashkuara Arabe nisin vaksinimin kundër Covid-19

ABU DHABI, 14 DHJETOR - Emiratet e Bashkuara Arabe nisin të hënën programin publik të vaksinimit kundër sëmundjes Covid-19, duke përdorur injekzionin e bërë nga gjiganti kinez i ilaçeve, "Sinopharm". Programi nisi në kryeqytetin Abu Dabi, ku së paku 45 spitale dhe klinika janë duke marrë pjesë.

Programi i bën Emiratet e Bashkuara Arabe një nga vendet e para që nisin imunizimin masiv. Banorët në kryeqytet mund të rezervojnë falas takimin për vaksinë, pasqyruar edhe

përmes shërbimeve lokale shëndetësore. Sipas të dhënave të Universitetit "Johns Hopkins", Emiratet e Bashkuara kanë konfirmuar mbi 186 000 raste me Covid-19. Prej tyre, 618 pacientë kanë vdekur.

Të hënën Shtetet e Bashkuara, po ashtu, nisin imunizimin e popullsisë nga kjo sëmundje, por me vaksinën e bërë nga kompania amerikane "Pfizer" dhe ajo gjermane "BioNTech". Kjo vaksinë ka nisur të përdoret javën e kaluar edhe

Covid-19, sëmundje që shkaktohet nga një koronavirus i ri, ka prekur mbi 72 milionë njerëz në të gjithë botën. Prej tyre, mbi 1.6 milion kanë vdekur dhe mbi 47 milionë janë shëruar. ShBA-ja është vendi më i prekur në botë, me mbi 16 milionë të infektuar dhe me afro 300 000 viktima.

Vaksinat e para, kudo në botë, është thënë se do t'i marrin punonjësit shëndetësorë dhe grupet e njerëzve më të rrezikuar, kryesisht të moshuarit.



Italia planifikon vendosjen e masave më të rrepta kundër pandemisë



ROMË, 14 DHJETOR - Italia po konsideron vendosjen e kufizimeve më të rrepta kundër pandemisë gjatë festave të Krishtlindjes dhe Vtitit të Ri. Autoritetet janë të shqetësuar se në muajin janar mund të ketë rritje të numrit të të infektuarve me koronavirus. Të dielën turma të njerëzve u dyndën në dyqane dhe qendra tregtare, pasi vendi ka lehtësuar disa prej masave që kishte vendosur muajin e

kaluar. Më 13 dhjetor Italia raportoi 484 vdekje të lidhura me koronavirusin. Të shtunën ky vend tejkaloj Britaninë e Madhe si vendi evropian me numrin më të lartë të vdekjeve. Qeveria mund të vendosë masat nën të ashtuquajturat rregulla bllokimi "të zonës së kuqe" nga 24 dhjetori deri të paktën më 2 janar, duke zgjatur orën policore gjatë natës, pastaj duke ndaluar lëvizjen

johelbësore dhe mbylljen e dyqaneve, bareve dhe restoranteve gjatë fundjavave dhe pushimeve, me përjashtim të atyre që shesin mallra thelbësore, raportuan mediat italiane. "Turmat e njerëzve janë të pajustifikueshme, irrationale, të papërgjegjshme", i tha ministri italian i Çështjeve Rajonale, Francesco Boccia, të përditshmes italiane "La Repubblica".

Shërbimet e Googles bien nga sistemi në disa vende të botës

NJU JORK, 14 DHJETOR - Shumë shërbime nga Alphabet Inc, duke përfshirë YouTube, Gmail dhe Google Drive, kanë pasur çrrëgullime në funksionim përmijëra përdorues në të gjithë botën të hënën. Ndërprerja në funksionim filloj pak para mesditës, duke zgjatur më shumë se gjysmë ore, para se të kthejë në funksion, transmeton BBC. Platforma për videot e kompanisë nuk lejonte ngarkimet përmësuese dhe atyre u paraqitej mesazhi "Dıckा nuk funksionon".

Motori i kërkimit i Google, megjithatë, mbeti i paprekur nga problemet që përfshin shërbimet e tjera. Sipas faqes në internet që merret me monitorimin e ndërprerjeve "DownDetector", më shumë se 12 000 përdorues të


YouTube u prekën në pjesë të ndryshme të botës, përfshirë Shtetet e Bashkuara, Britaninë dhe Indinë. Çrrëgullime janë raportuar edhe në Kosovë dhe vende të tjera.

BBC ka kontaktuar Google për t'i komentuar arsyet e çrrëgullimit, por një zëdhënës tha se ata nuk ishin në gjendje të hynin në e-mailin e tyre gjatë ndërprerjes. Shumë individë dhe biznese mbështeten në shërbimet e Googles përmësuese aplikacionet themelore të punës si posta elektronike dhe kalendarët.

Dështime të tilla në sistemet e Googles janë të rralla, megjithëse një problem me disa serverë shkaktoi vështirësi përmësuese e Shteteve të Bashkuara në qershori të vitit 2019.



Trumpi refuzon ta marrë vaksinën këtë javë



WASHINGTON, 14 DHJETOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka refuzuar planin që parashikonte marrjen e

vaksinës nga zyrtarët e lartë në Shtëpinë e Bardhë këtë javë. Zyrtarët amerikanë thanë më parë se punonjësit e Shtëpisë së Bardhë pritet ta marrin të parët

vaksinën e kompanisë "Pfizer/BioNTech". Presidenti Trump u shpreh se njerëzit që punojnë në Shtëpinë e Bardhë mund ta marrin vaksinën më

vonë në programin e përcaktuar përmësuese, përvëç rasteve të veçanta. Sipas studimeve, vaksina siguron 95 përqind mbrojtje nga Covid-19.

Partitë politike, ende pa konsensus për emrin e presidentit të ri

Hoti: Nëse s'do të ketë zgjidhje për presidentin, të shkojmë në zgjedhje



Partitë politike në Kosovë ende nuk po arrijnë pajtim për një marrëveshje për emrin e presidentit të ri pavarësisht prej paralajmërimeve për një tryezë në të cilën do të diskutohej zgjedhja e presidentit të ri. Deri më tanjë më shumë ka deklarata nga të gjitha partitë politike për opsjonin që vendi të shkojë në zgjedhje të reja. Kryeministri Avdullah Hoti ka përsëritur sërish të hënën se nëse nuk do të ketë zgjidhje për emrin e presidentit të ri, vendi duhet të shkojë në zgjedhje të parakohshme. Duke e parë këtë situatë rrëth kësaj çështje, analistët politikë u kanë bërë thirrje partive politike për reflektim

konstruktivitet. Emri i presidentit kalon nëpër zyrat e LDK-së", kështu ka thënë Haziri duke iu përgjigjur në njëfareë mënyre kryetarit të AAK-së, Ramush Haradinaj, i cili ka shpallur kandidaturën për president dhe deklaratave të zyrtarëve të PDK-së që ky post i takon kësaj partie. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se ka ofruar kandidaturën e tij për president të Kosovës dhe nëse kjo ndodh, ai thotë se më nuk do të kthehet në partinë që e themeloi pas luftës, AAK-në. Ai e ka bërë të qartë se nëse nuk do të jetë ai për president, atëherë vendi duhet të shkojë në zgjedhje. "Nuk e shoh si shqetësim këtë për vete, për aspektin politik, por për Kosovën. Kosova i ka energjitetë e brendshme për t'i kaluar këto. Aspektet e çështjes së zgjedhjes së presidentit do t'i zgjidhim në bazë të Kushtetutës. Si aleancë kemi dhënë një opzion që është një marrëveshje politike. Opzion tjetër janë zgjedhjet. Nëse ka mirëkuptim nga palët, e mirëpresim; nëse jo, jemi në

zgjedhje", është shprehur Ramush Haradinaj. Kryetari në detyrë i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Enver Hoxhaj, i quan të papranueshme shantazhet e subjekteve të tjera politike të cilat deklarojnë se nëse nuk ka konsensus për emrin e presidentit, vendi shkon në zgjedhje. "Partia Demokratike e Kosovës nuk shantazhohet dhe as nuk do të lejoj që dikush ta marrë peng shtetin e Kosovës. Jemi të gatshëm që të ulemi dhe të bisedojmë me çdo parti politike parlamentare që ta tejkalojmë krizën institucionale në vend dhe ta zgjedhim një president dinjitoz që i shërben unititetit të brendshëm dhe thellon partneritetin me aleatët tanë. Por, PDK-ja nuk do të bëhet palë e një procesi që do të prodhonte një president që thellon përcarjen e brendshme dhe e izolon Kosovën jashtë", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka shtuar se Republika e Kosovës është mbi interesat politike dhe egot personale. "Kushdo që kërkon votat e deputetëve të PDK-së në Kuvendin e Kosovës, duhet ta kuptojë njëherë e përgjithmonë, që në atë propozim e ka brenda edhe kandidatin e PDK-së. Barrikadimi pas propozimeve individuale, ende pa filluar një diskutim politik ndërmjet partive parlamentare, është i dëmshëm dhe nuk e ndihmon tejkalimin e krizës, por vetëm thellimin e saj", ka deklaruar Hoxhaj.

Ndërkaq partia më e madhe opozitare, Lëvizja Vetëvendosja, me këmbëngulje kërkon që Kosova të mbajë zgjedhje dhe pas zgjedhjeve, ashtu siç e parasheh

Kushtetuta, në Kuvend të zgjedhet presidenti i ri. Lideri i kësaj partie, Albin Kurti, ka bërë të qartë se arsyë substanciale përfshijnë shkuar në zgjedhje e shtetit legjitimiteti qytetar për bartësit e

Njohësit e proceseve politike në vend kanë thënë se liderët e partive politike, të pozitës dhe të opozitës, duhet të ulen dhe të gjejnë një zgjidhje për presidentin.

Analisti politik Ramush Tahiri ka thënë se konsensusi i partive politike për ta zgjedhur presidentin e ri do të siguronte stabilitet institucional. Tahiri pret që të ndodhë tryzea e partive politike për çështjen e presidentit. "Dëshiroj që kjo tryezë të ketë sukses dhe partitë politike të bëjnë një konsensus për zgjedhjen e presidentit të ri. Zgjedhja e presidentit do të siguronte stabilitet politik edhe nëse vendi do të shkonte në zgjedhje të reja. Pra, nuk do të ishte e njëjtë situatë sikurse vendi të shkojë në zgjedhje me ushtrues të detyrës së presidentit", ka thënë ai.

Edhe njoftimi i proceseve politike, Mazlum Baraliu, ka thënë se zgjidhja e vetme është që partitë politike dhe koalicioni qeverisës duhet të merren vesh për një president konsensual, pastaj të shkohet në zgjedhje të reja.

Baraliu nuk pret diçka pozitive nga paralajmérimi i partive përtryezë politike për të diskutuan për zgjedhjen e presidentit të ri. "Fatkeqësisht, duke e parë klimën politike të veprimit, kalkulimeve dhe të ambicieve politike që ndonjëherë janë të pazakonshme dhe të paarsyeshme, sepse njerëzit të imponohen duke mos u bazuan

apo vrarë mendjen në fuqinë politike që kanë dhe vullnetin e qytetarëve që kanë marrë, qytetarët me këtë klasë politike që 20 vjet janë lodhur dhe zhgënijer. Këtë lodhje dhe zhgënjim të qytetarëve nuk po e sheh si duket kjo klasë politike. Po shihet një përpjekje e tyre më shumë për pushtet dhe jo për avancim të shtetit. Këto parti politike, secila në mënyrën e vet, me përjashtime të vogla ose fare, po dëshmojnë se nuk e kanë angazhimin e tyre politik për shtetin dhe qytetarët, por për interesat e tyre të ngushta partiake dhe për kalkulimet e tyre”, ka thënë ai, duke bërë thirrje që partitë politike të reflektojnë. “Eshtë momenti i fundit që të reflektohet” ka thënë Baralju

Pas dorëheqjes së Hashim Thaçit nga posti i presidentit, pasi ai u akuzua për krimë lufte nga Dhomat e Specializuara, ushtruese e detyrës në këtë pozitë, sipas Kushtetutës, u zyrtarizua Vjosa Osmani, kryetare e Kuvendit. Kështu parashihet në nenin 90 të Kushtetutës së Kosovës, por kjo nuk mund të zgjasë më shumë se gjashtë muaj, dhe nëse partitë politike nuk merren vesh për një emër konsensual, atëherë vendi duhet të shkojë në zgjedhje për një përbërje të re të Kuvendit. Për zgjedhjen e presidentit është e obligueshme që në sallë të janë më së paku 80 deputetë.

Nëse në dy raundet e para dështon zgjedhja e presidentit që kërkon dy të tretat e votave nga 120 deputetë, atëherë në raundin e tretë presidenti mund të zgjidhet me një shumicë të thjeshtë prej 61 votash, gjithsesi me një kuorum të obligueshëm prej 80 deputetësh në sallë.



FLET PËR "EPOKËN E RE" KOMANDANTI I FSK-SË, RRAHMAN RAMA

PLANI I TRANZICIONIT TË FSK-së PO ZBATOHET ME PARAMETRA POZITIVË

Në dyvjetorin e zyrtarizimit të mandatit ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), komandanti i kësaj force, gjeneral Rrahman Rama, ka thënë se është bërë punë e madhe në planin e tranzicionit. Në këtë intervistë dhënë për gazeten "Epoka e re", ai ka thënë se për këto dy vjet ka parametra pozitivë për ecurinë dhe zhvillimin e FSK-së. Gjeneral Rama ka thënë se i kanë tejkaluar pritshmëritë sa i përket realizimit të planit gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së. Ai ka treguar se faza e parë e tranzicionit të FSK-së pritet të përmbyllët në fillim të vitit të ardhshëm, për të filluar pastaj me fazën e dytë të tranzicionit që, sipas tij, është më sfiduese dhe më komplekse. "Në këtë fazë do ta fillojmë ngritjen e kapaciteteve me mandat dhe mision të ri duke u bazuar në ligje dhe në obligimet tona kushtetuese për mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit të vendit", ka thënë Rama

**EPOKA
ERE** Mal QORRAJ

PRISHTINË, 14 DHJETOR -

"**Epoka e re**": Z. Gjeneral, Rama u bënë dy vjet nga votimi në Kuvendin e Kosovës për themelimin e ushtrisë së Kosovës. Sot, cili është zhvillimi i FSK-së?

Rama: Zhvillimi i FSK-së për këto dy vjet është pozitiv. Këtë e thonë edhe faktet. Pas ndryshimeve të kornizës ligjore para dy vjetësh, FSK-së i janë dhënë detyra shtesë mbi bazën e

ligjeve të reja nga ana e Kuvendit dhe në këtë drejtim ne kemi filluar dhe ndërtuar një plan gjithëpërfshirës të tranzicionit të FSK-së. Pra, mbi bazën e atij plani kemi filluar zbatimin e ligjeve të votuara në Kuvendin e Kosovës. Plani i tranzicionit është aprovuar në qeveri dhe në koordinim edhe me partnerët tanë ndërkombëtarë. Faza e parë e tranzicionit presim të përmbyllët në fillim të vitit të ardhshëm. Pavarësisht prej sfidave që kemi pasur gjatë kësaj periudhe, sidomos me

pandeminë, angazhimi i FSK-së për përkrahje të autoriteteve civile ka vazhduar. Mund të them me përgjegjësi të plotë se i kemi tejkaluar pritshmëritë tona për realizimin e planit gjithëpërfshirës. Edhe pse këto vitet e para kanë qenë më shumë në kuptimin administrativ të ndryshimit të rregulloreve, procedurave, standardeve operative dhe të manualeve, kanë marrë kohë, por mund t'ju them se jemi në përfundim e sipër të planit gjithëpërfshirës.

"**Epoka e re**": Për të zbatuar këtë plan të tranzicionit të FSK-së sigurisht se duhet edhe buxhet. Sa keni përkrahje nga institucionet qendrore tash për vitin 2021?

Rama: Gjatë këtyre dy vjetëve, duke u bazuar në planin tonë, kemi pasur përkrahje nga institucionet qendrore, në këtë rast nga qeveria sa i përket buxhetit. Nuk kemi pasur asnjë problem për realizimin e objektivave dhe detyrave tona.

Sa i përket buxhetit për 2021, sigurisht se e kuptojmë situatën në të cilën ndodhemi si vend në aspektin ekonomik, tash së fundi edhe si pasojë e pandemisë që është një

problem global, pra jo vetëm i Kosovës. Kemi kërkuar buxhet shtesë sa i përket zbatimit të fazës së parë. Jemi në kontakt me kryeministrin dhe kemi zotime se janë në përkrahje të FSK-së duke u bazuar në planin

dhe kërkuesat buxhetore. Kështu që nuk do të kemi problem në këtë drejtim. Kemi pasur takime të vazdueshme edhe me komisionet parlamentare dhe me Kuvendin si institucion. Pra,

besoj se do ta kemi përkrahjen e duhur nga institucionet qendrore në mënyrë që ne ta zbatojmë planin gjithëpërfshirës të FSK-së. Faza e dytë e tranzicionit do të jetë më sfiduese dhe më komplekse. Në këtë fazë do ta fillojmë ngritjen e kapaciteteve me mandat dhe mision të ri duke u bazuar në ligje dhe në obligimet tona kushtetuese për mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit të vendit.

"**Epoka e re**": A ka ndikuar kjo periudhë njëvjeçare e pandemisë Covid-19 për zbatimin e planit që keni për tranzicionin e FSK-së?

Rama: Pandemia nuk ka ndikuar në planin e tranzicionit, prandaj edhe i kemi tejkaluar pritshmëritë tona dhe planin e tranzicionit. FSK-ja ka dhënë përkrahje ndaj autoriteteve civile për përballje me këtë pandemi, pasi ky është edhe obligimi ynë ligjor.

"**Epoka e re**": Faza e dytë e tranzicionit, a parashev edhe armatim më të madh për FSK-në?

Rama: Ne edhe në pjesën e parë



nga partnerët tanë, sidomos ata strategjikë.

“Epoka e re”: Z. Gjeneral, FSK-ja edhe këtë vit doli institucion i më i besueshëm. Çfarë do të thotë kjo për ju si dreitues i kësaj forcë?

Rama: Ndihem krenar dhe i privilegjuar. Kjo nuk është meritë e imja, por e të gjithë pjesëtarëve të FSK-së. Është meritë e djemve dhe vajzave që janë duke shërbyer me përkushtim dhe angazhim maksimal, por edhe me disiplinë. Në saje të punës, angazhimit dhe përkushtimit të tyre ne jemi për nëntë vjet institucioni më i besueshëm në vend. Ne do të vazhdojmë ta mbajmë këtë pozitë dhe jemi të vetëdijshëm se çdo tranzicion i ka edhe sfidat e veta. Ne do të vazhdojmë t'u dalim në ndihmë të gjithë qytetarëve pa dallime dhe këtë jemi duke e dëshmuar çdo ditë. Në radhët e FSK-së janë të integruar të gjitha komunitetet dhe po shërbejnë me integritet.

shtetet e tjera, duke filluar prej Shqipërisë, Malit të Zi, Kroacisë, Sllovenisë dhe Maqedonisë së Veriut. kemi



oficerë që shkollohen në këto vende. Gjithashtu, këto vende përdorin edhe aftësítë tonë që i kemi ndërtuar si FSK.



Mblidhet Forumi i Donatorëve për Rimëkëmbje Ekonomike

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) -
Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, udhëhoqi takimin e Forumit të Donatorëve për Rimëkëmbje Ekonomike. Në këtë takim me përfaqësues nga Zyra e BE-së në Kosovë, vendet donatore, agjencitë zhvillimore dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare, me pjesëmarrjen e zëvendëskryeministrit Driton Selmanaj dhe ministres së Financave, Hykmete Bajrami, u



diskutua për qasjen e përbashkët
të qeverisë dhe donatorëve për ta

financiar rimëkëmbjen ekonomike, pas pandemisë

Covid-19, si dhe agjenda afatgjatë zhvillimore e Kosovës. Gjatë takimit kryeministri Hoti falënderoi donatorët për përkrahjen e vazhdueshme për Kosovën, veçanërisht për tejkalimin e pasojave të pandemisë Covid-19. Ai kërkoi përfshirjen direkte të donatorëve për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike, ku edhe shpalosi hollësi për formën e implementimit të saj. Gjatë takimit u prezantua gjendja aktuale rrëth menaxhimit të

pandemisë Covid-19 dhe masave të programit që janë planifikuar për vitin 2021, të cilat synohet të ndërlidhen me përkrahjen e ofruar nga donatorët. Në këtë takim u prezantua agjenda zhvillimore e Qeverisë së Kosovës për dekadën e ardhshme, me të cilën synohet rritja e përfitimit nga iniciativat dhe instrumentet e reja financiare, veçanërisht fondet e ofruara në kuadër të Planit të BE-së për Ekonomi dhe Investime të Ballkanit Perëndimor.

Pesë viktima dhe 329 raste të reja me Covid-19 në Kosovë

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) -
Pesë viktima dhe 329 raste
të reja me koronavirus u
raportuan të hënën në
Kosovë. Instituti Kombëtar i
Shëndetësisë Publike
(IKShPK) ka njoftuar se
viktimat janë regjistruar në:
Prishtinë, Prizren, Giakovë,

Fushë Kosovë dhe Suharekë

Rastet e reja pozitive, ndërkaq, rezultuan nga testimi i 1 327 mostrave. Numri më i madh i tyre u regjistrua në Prishtinë: 149. IKShPK-ja, po ashtu, tha se në 24 orët e fundit, 555

pacientë janë shëruar nga koronavirusi

Kosova, në total, ka konfirmuar 46 909 raste me koronavirus. Prej këtyre, 1 203 pacientë kanë vdekur dhe 34 155 janë shëruar. Raste aktive aktualisht janë 11 551.



Gjykata Speciale konfirmon aktakuzën kundër Gucatit dhe Haradinajt

“Epoka e re”

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Gjykata Speciale në Hagë ka konfirmuar aktakuzën kundër dy udhëheqësve të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj. Lajmin e ka dhënë, në llogarinë e vet në “Facebook”, avokati Tomë Gashi, i cili ka thënë se aktakuza kundër Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucatit përmban katër pika, të cilat, sipas Prokurorisë Speciale në Hagë, kanë të bëjnë me pengim të drejtësisë dhe që ndërlidhen me periudhën kohore 7-25 shtator. “Nasim Haradinaj dhe Hysni Gucati nga data 25 shtator 2020 deri më sot e kanë konsideruar vete të kidnapuar nga Gjykata Speciale. Sot është konfirmuar aktakuza kundër tyre, e cila përbën katër pika, të cilat, sipas Prokurorisë Speciale në Hagë, kanë të

bëjnë me pengim të drejtësisë, e me akuza konkrete që, sipas saj, ndërlidhen me periudhën kohore në mes të datave 7 deri 25 shtator të këtij viti. Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucatit sot u është dorëzuar aktakuza e konfirmuar nga gjyqtari i procedurës paraprake dhe tani pritet dalja e tyre para gjyqtarit në seancat e radhës. Kryetari dhe nënkyretari i OVL të UÇK-së dhe unë në cilësinë e avokatit të OVL të UÇK-së nuk e pranojmë këtë gjykatë njëetnike, raciste, tepër e dëmshme për kombin tonë shqiptar dhe për shtetin e pavarur të Kosovës”, ka thënë avokati Gashi në një deklaratë për media.

Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë nuk ka njoftuar ende për konfirmimin e aktakuzës. Haradinaj dhe Gucati janë arrestuar më 25 shtator në Prishtinë nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, me mbështetjen e Misionit të Bashkimit Evropian për



Hysni Gucati



Nasim Haradinaj

Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX, dhe të Policisë së Kosovës. Fillimi nuk janë dhënë detaje për arsyet e

lëshimit të fletarrestimeve, por më vonë është thënë se ata kanë penguar drejtësinë. Tri herë gjatë shtatorit Organizata

e Veteranëve të Luftës ka thënë se ka pranuar në mënyrë anonime dosje që lidhen me Prokurorinë Speciale.

Myftiu Tërnava priti në takim komandantin e ri të KFOR-it, vlerësohet toleranca ndërfetare



PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, myftiu Naim ef. Tërnava, ka pritur të hënën në takim komandantin e ri të KFOR-it, gjeneralmajorin Franco Federici. Në këtë takim njoës myftiu Tërnava i uroi mirëseardhje në Kosovë gjeneralmajorit Federici, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe të suksesshme në misionin e tij. Ai më pas e njoju me punët dhe aktivitetet që zhvillon institucionin i Bashkësisë Islame të Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve pa dallim. Myftiu Tërnava edhe një herë shprehu mirënjojen e tij për misionin e KFOR-it, duke shprehur kështu vlerësimin

dhe respektin e lartë që kanë qytetarët e Kosovës për ta. Nga ana e tij, gjeneralmajori Federici ka falënderuar myftin Tërnava për pritjen, duke e vlerësuar lart punën dhe angazhimin që ka Bashkësia Islame e Kosovës për mirëqenien e të gjithë qytetarëve. Ai, po ashtu, ka vlerësuar harmoninë ndërfetare, tolerancën dhe bashkëjetesën ndërmjet gjithë qytetarëve pa dallim. Gjeneralmajori Federici ka shprehur gatishmërinë e tij dhe të KFOR-it për krijimin e sigurisë për të gjithë qytetarët. Në fund të takimit, të dyja palët shkëmbjen mes vete stemat e institucioneve që ata udhëheqin.


Një pastrues në Qendrën Korrektuese në Dubravë zihet me substancë narkotike

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Në Qendrën Korrektuese në Dubravë oficerët korrektues kanë arritur ta parandalojnë futjen kontrabandës brenda qendrës.

Oficerët korrektues gjatë kontrollit në portën hyrëse të qendrës kanë hetuar se F. L., i punësuar pastrues në Qendrën Korrektuese në Dubravë, kishte të fshehur në rrobat e veta substancë të dyshuar narkotike. Pasi kanë hetuar

substancën e dyshuar narkotike, menjëherë janë ndërmarrë veprimet e nevojshme nga stafi përgjegjës i sigurisë, të cilët kanë lokalizuar vendin, provat materiale dhe zyrtarin e dyshuar. “Lidhur me rastin është njoftuar Njësiti Antidrogë i Policisë së Kosovës, ndërsa ndaj të dyshuarit është ndërmarrë masa e suspendimit nga puna dhe menjëherë është iniciuar procedurë e brendshme disiplinore.

Shërbimi Korrektues i Kosovës mbetet i përkushtuar përluftimin e dukurive negative, ku hyjnë luftimi i kontrabandës, substancave narkotike, korrupsionit dhe keqpërdorimit të pozitës zyrtare, dhe nuk do të lejojë në asnjë mënyrë rrezikimin e institucioneve korrektuese nga dukuritë dhe veprimet e tillë, është bërë me dije në njoftimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK).



Finalizohet projektligji që i jep kompetenca AKK-së për parandalim të korruptionit

Ministria e Drejtësisë ka finalizuar Projektligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit. Lajmin e ka bërë me dije të hënën ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, i cili ka theksuar se përmes këtij projektligji Agjencia Kundër Korruptionit merr kompetenca të qarta në funksion të parandalimit të korruptionit duke përcaktuar përfundimisht një kornizë efektive anti-korruption. Ai ka treguar se një ndër risitë më të veçanta të këtij projektligji është se AKK-ja do të ketë kompetenca për të shqiptuar masa administrative dhe gjoba në rast të shkeljes së dispozitave ligjore

EPOKA ERE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, në kuadër të javës Kundër Korruptionit, në një konferencë për media, bashkë me drejtorin e Agjencisë Kundër Korruptionit, Shaip Havollit, ka njoftuar opinionin publik se Ministria e Drejtësisë ka finalizuar Projektligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit. "Në shënim të Javës Kundër Korruptionit, Ministria ka finalizuar punët rrreth Projektligjit për Agjencinë për Parandalimin e Korruptionit. Grupi punues gjatë hartimit të draftit ka marrë parasysh komentet dhe rekandimet nga mekanizma dhe raporte të

ndryshme qofshin këto organizata vendore dhe ndërkombëtare, me theks të veçantë duke marrë për bazë edhe rekandimet e dala nga procesi i Rishikimit FunkSIONAL të Sektorit të Sundimit të Ligjit", tha ministri Selimi. Çështjet kryesore të trajtuar nga ky projektligji, sipas ministrit Selimi, kanë konsistuar në nevojën dhe qëllimin e plotësimit dhe ndryshimit nga ligji paraprak i cili është në fuqi. "Në versionin aktual të projektligjit janë të trajtura të gjitha çështjet që u referohen pengesave për zbatim nga ana e organit zbatues dhe atyre çështjeve që nuk kanë qenë të mbuluar me dispozita përkatëse ligjore e që i referohen Agjencisë", ka deklaruar ministri



Selimi.

Gjatë konferencës, ministri Selimi tregoi se përmes këtij projektligji Agjencia merr kompetenca të qarta në funksion të parandalimit të korruptionit duke përcaktuar përfundimisht një kornizë efektive anti-korruption, përcakton kompetencat ligjore të Agjencisë në fushën e parandalimit të korruptionit, veçanërisht në fushën e hetimeve administrative në lidhje me parandalimin e konfliktit të interesit, procesit të deklarimit të pasurisë dhe dhuratave dhe çështjet që ndërlidhen me sinjalizuesit. "Për

më tepër, një ndër risitë më të veçanta të këtij projektligji është se Agjencia do të ketë kompetenca për të shqiptuar masa administrative dhe gjoba në rast të shkeljes së dispozitave ligjore, që e vendos Agjencinë në një stad shumë të avancuar në rolin e saj për parandalimin e korruptionit", u shpreh ministri Selimi.

Sipas tij, risi tjetër e këtij projektligji është se Agjencia do ta monitorojë Strategjinë Anti-Korruption e cila do të jetë dokument udhërrëyes për institucionet e Kosovës, e draftuar dhe miratuar nga qeveria si

manifestim i vullnetit politik. "Për më tepër, Agjencia do të ketë kompetenca shtesë sa i përket: Vlerësim kundër-korruption të akteve ligjore, Vlerësim i rrezikut të korruptionit, dhe Planeve të Integritetit. Ministria e Drejtësisë, pas marrjes së deklaratave përkatëse, projektligjin do ta procedojë pa vonesë për miratim në qeveri", ka thënë ministri Selimi.

Drejtor Havollit, në fjalën e tij para medieve, ka thënë se me këtë projektligji Agjencisë i shtohen kompetencat dhe rritet efikasiteti i punës së AKK-së në luftën kundër korruptionit.

PDK-ja: Qeveria dështoi me arsimin gjatë pandemisë

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Anëtar i Kryesisë së Partisë Demokratike të Kosovës PDK, Muzafer Shala, ka mbajtur të hënën një konferencë për media

përmes së cilës ka denoncuar mënyrën e dobët të organizimit të procesit arsimor nga qeveria.

Shala ka thënë se Kosova sot përballet me një situatë të patolerueshme të keqmenaxhimit të procesit mësimor nga ana e qeverisë Hoti, e veçanërisht Ministria e Arsimit. "Partia Demokratike e Kosovës edhe sot, sikurse ka bërë në vazhdimësi, shpreh pakënaqësinë e thellë me situatën aktuale të arsimit në vendin tonë, mënyrën e menaxhimit dhe neglizhencën e madhe të treguar. E pyet që sot e shtrojmë nga kjo konferencë, edhe unë si prind, por edhe shumë familje e prindër kudo në Kosovë është: Çfarë po ndodh me shkollimin e fëmijëve tanë gjatë kohës së pandemisë? A di kush nëse qeveria ka një plan përruajtjen e cilësisë dhe të shtrirë në një plan kohor më afatgjatë dhe të mirëmenduar?

Fatkeqësish, deri më tanë nuk ka ndodhur as njëra e as tjetra. Shohim vetëm improvizim, por jo plan të menduar mirë", ka thënë ai.

Shala e ka quajtur skandaloz vendimin e fundit të Ministrisë së Arsimit për ta zgjatur pushimin dimëror për nxënësit të cilët edhe ashtu kanë mbajtur shumë më pak orë sesa në vitet paraprake. Madje ai ka thënë se këto vendime absurde po rrezkojnë edhe të ardhmen e fëmijëve tanë. "Qeveria e Kosovës është në gjumë ose më mirë të thuhet e paaftë sa i përket organizimit të procesit mësimor në kohë pandemie. Madje që është edhe më keq, nuk ka arritur ta implementoje as gjysmën e planit të propozuar vetë për fillimin e vitit të ri shkollor 2020/2021 në kushte pandemie", është shprehur Shala. Në fund, ai ka propozuar një sërë pikash për qeverinë të cilat duhet të implementohen menjëherë, duke nisur nga vendosja urgjente e mekanizmave konkretë përsigurimin e cilësisë në kohë pandemie.



Reçica: aftësimi profesional, çelës për zbutjen e papunësisë

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, të hënën mori pjesë në prezantimin e Barometrit të Tregut të Punës në Kosovë, organizuar në kuadër të projektit "Harmonizimi i Arsimit dhe i Aftësimit me Nevojat e Tregut të Punës - ALLED Faza II", i financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkëfinancuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC), dhe që zbatohet nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA), të cilët edhe i ka falënderuar për kontributin e tyre edhe në këto rrerhane të vështira pandemike. "Eshtë fakt që pandemia e ka venë në

vështirësi tregun e punës dhe punësimin në Kosovë, mirëpo këtë situatë synojmë ta zbusim sadopak përmes Ligjit për Rimëkëmbje Ekonomike, i cili do të ndihmojë me mbështetje financiare një numër të madh të punonjësve të cilët kanë humbur vendin e punës, ku ne si Ministri e Punës dhe Mirëqenies Sociale, përmes pikës 3 të Planit për Rimëkëmbje Ekonomike, kemi për objektiv subvencionimin në pagë të rrith 2 000 punonjësve dhe të vazhdojmë me masa aktive të tregut të punës, si dhe trajnime dhe aftësimë profesionale", ka thënë ministri Reçica. Reçica, gjithashtu, ka thënë se problemi kryesor i tregut të punës në Kosovë është



mospërputhshmëria e aftësive profesionale me nevojat e fuqisë punëtore të këruara nga tregu i punës, ku ne si MPMS/Agjenci e Punësimit kemi mbyllur disa herë vitin me kërkesën për të mbuluar mijëra vende pune,

ndërkaq në regjistrin e punëkërkueseve kemi rreth 200 000 punëkërkues. Prandaj, ai tha se "si Qeveri e Kosovës ne duhet të koordinohemi të gjëjmë zgjidhjen e papunësisë në Kosovë, fillimisht të trajtojmë

numrin e punëkërkuesve të regjistruar me një plan të veçantë dhe pastaj të krijojmë politika të edukimit bazuar në nevojat e tregut të punës, gjithashtu t'i fuqizojmë shkollat e aftësimit profesional".

Ministri Reçica në fund të fjalës së tij gjatë këtij prezantimit ka thënë se ne si MPMS jemi tejet të përkushtuar ta avancojmë digitalizimin e proceseve të punës, ofrimin e shërbimeve publike të punësimit, gjithashtu shërbimet e trajnimeve profesionale. Gjithsesi, na duhet koordinim më i gjerë i të gjitha institacioneve, por edhe sektorit privat, me qëllim që këto aftësimë profesionale të janë në bashkërendim me nevojat e bizneseve.

Abrashi dhe Ahmeti nënshkruajnë memorandum, vitin e ardhshëm nis ndërtimi i rrugës A

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Ministri i Infrastrukturës, Arben Abrashi dhe kryetari Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti, kanë nënshkruar memorandum bashkëpunimi për financimin e disa projekteve të rëndësishme infrastrukturore në kryeqytet. Abrashi ka thënë se memorandumi që u nënshkrua është rezultat i një

pune të gjatë që e kanë bërë ekipet e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Komunës së Prishtinës. Ai ka veçuar projektet që do të finalizohen me këtë memorandum, e një ndër më të rëndësishmit është ndërtimi i rrugës A në Prishtinë, që do të ketë impakt të madh në Lagjen e Spitalit dhe Mati 1. "Sot po konkretizohet një punë disamujore që është punuar nga ekipet e ministrisë dhe komunës, me përkrahjen time

dhe të kryetarit. Ka të bëj me projektet që e lehtësojnë jetën dhe qarkullimin në Prishtinë. Memorandumi parashev zgjerimin e rrugës nga Prishtina deri në Gracanicë, zgjerimin e rrugës për në Grashticë, ndërtimin e rrugës A dhe ndërtimin e rrugës nga Kodra e Trimave në Shkabaj. Besoj se në vitin e ardhshëm disa prej këtyre projekteve do të marrin formë dhe do të realizohen", ka thënë Abrashi. Ndërsa kryetari i Komunës së

Prishtinës, Shpend Ahmeti, ka thënë se për herë të parë Prishtina po e merr vendin e merituar në buxhetin e nivelit qendror. "Për herë të parë po nënshkruajnë marrëveshje më të thelluar, sepse kemi nënshkruar edhe më herët, ku Prishtina e ka vendin e merituar në buxhetin e nivelit qendror. Kësaj radhe vërtet janë projekte që kanë rëndësi për Prishtinën dhe i kemi koordinuar bashkë të gjitha

punët", ka thënë Ahmeti. Memorandumi parashev zgjerimin e rrugës Nacionale N9 Prishtinë-Mutivodë, zgjerimin e rrugës nga ura e Veternikut deri në hyrje të Graçanicës, asfaltimin e rrugës që lidhë rrugët nacionale N2 me N25 për te qendra e panaireve, ndërtimin e kolektorit në Hajvali, dizajnimin e segmentit nga Çagllavica deri në Prishtinë dhe ndërtimin e rrugës A me kolektorin e ujërave të zeza.

rastrukture
structure

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo

Qeveria / Vlada / Government

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

www.mi-ks.net

www.mi-ks.net

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

Ministria e Infrastrukturës

Ministarstvo Infrastrukture / Ministry of Infrastructure

is
Infrastructure

Lansohet pakoja e rimëkëmbjes ekonomike nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), në bashkëpunim me Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe donatorët ndërkombëtarë, ka lansuar Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike.

Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike (PRE) është një linjë e re garantuese që do të operojë në kuadër të FKGK-së dhe që ka për qëllim mbështetjen e Ndërmarrjeve Mikro të Vogla dhe të Mesme (NMVM) përmes garantimit të kredive, thuhet në njoftimin për media. "Kjo pako parashev ta rritë mbulueshmërinë me garacion kreditor deri në 80 për qind të vlerës së kredisë, si dhe do t'u ofrojë mundësi edhe fermerëve me Numër Identifikues të Fermerit (NIF). Në kuadër të pakos do të operojnë pesë-dritare që do t'i adresojnë

nevojat e segmenteve të caktuara të tregut. Nga kjo pako pritet të ndihmohet qasja në financa për ndërmarrjet e ndikuara nga kriza si dhe ndërmarrjet me rëndësi strategjike për ekominë e Republikës së Kosovës. Dritaret garantuese brenda kësaj pakoje pritet ta mbështesin qasjen në financa për NMVM-të në vlerë deri në 202,000,000 euro për një periudhë njëvjeçare", bëhet me dije në njoftimin për medie. Zhvillimi i PRE-së do të ketë në fokus mbështetjen e kreditimit në sektorët e prodhimit, agrobiznesit, shërbimeve, tregtisë, me fokus të veçantë për gratë në biznes, bizneset e reja (start-up në ICT) dhe investimet në eficiencë të energjisë. "PRE në këtë kohë pandemie do të ketë vlerë të shtuar si përpërfituesit e fundit (NMVM-të) të cilëve do t'u mundësohet




qasje në financa me kushte më të mira të kreditdhënies në kohën adekuate, ashtu edhe për

Institucionet Financiare (IPF) të cilat do të kenë mundësi të ndajnë një

pjesë të madhe të riskut kreditor me FKGK-në", theksohet në këtë njoftim.

Hoti: Pavarësimi energjetik, sukses i përbashkët i Kosovës dhe miqve ndërkombëtarë



PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Nga dita e hënë KOSTT-i operon i pavarur, duke hapur kështu një histori të ri si zonë rregulluese brenda bllokut Shqipëri - Kosovë. Kryeministri i Republikës së Kosovës,

Avdullah Hoti, pavarësimin energjetik të Kosovës e vlerësoi sukses të madh për vendin. "Kjo është një arritje e madhe e cila ka ndodhur pasi që KOSTT-i ka plotësuar të gjitha kushtet e parapara me

marrëveshje dhe tani po operon i pavarur", ka thënë Hoti, i cili ka treguar se nga sot është vënë në funksion edhe linja e re me Shqipërinë. Ai nënvízoi se mbështetja e Qeverisë së Kosovës për

sektorin energjetik do të jetë maksimale ngaqë stabiliteti energjetik është parakusht për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit, për rritje të investimeve të brendshme dhe atyre të jashtme, si dhe në

funkcion të mirëqenies së qytetarëve. Këto komente kryeministri Hoti i ka bërë gjatë vizitës në KOSTT, ku ishte i shoqëruar nga ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi.

Kurti viziton qendrën tregtare në Ferizaj që nuk mban produkte të Serbisë



Prishtinë, 14 dhjetor (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka vizituar të hënën qendrën tregtare "Plus Center" në Ferizaj. Kjo qendër, sipas Kurtit, nuk mban asnje produkt të Serbisë. "Plus Center" në Ferizaj sot i mbushi 20 vjet. Bashkë me kryetarin e qendrës sonë i vizituam për t'i uruar punëtorët dhe pronarë

Sylejman Neziri. Tash e dy dekada nuk kanë mbajtur asnjëherë mallra të Serbisë dhe janë rritur e zgjeruar. I kanë 130 punëtorë në dy ndërrime (7:00 - 13:00 dhe 13:00 - 19:00) dhe nuk ka pushuar asnje punëtor nga puna për shkak të pandemisë. Në mesin e të punësuarve, pesë janë persona me nevoja të veçanta. Aty afër 'Plus

Center' vizituam edhe Fabrikën e Veglave në Ferizaj e cila u privatizua në valën e nëntë të vitin 2006, por nuk e ndërroi veprimtarinë. 70 punëtorë prodhojnë profile të shumta metalike e së fundi kanë nisur edhe prodhimin e pompave termike të cilat bëjnë kursim të madh të energjisë", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Përkujtohet heroi Mujë Krasniqi dhe 40 bashkëluftëtarët e tij në përvjetorin e rënies

SKENDERAJ, 14 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, i shoqëruar nga stafi i tij dhe shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, në 22-vjetorin e rënies së heroit Mujë Krasniqi dhe 40 bashkëluftëtarëve të tij, me homazhe në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë përkujtuam sakrificën dhe veprën e tyre për liri dhe pavarësi, luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Përmes këtyre homazhevë kryetari Jashari tha se po përkujtohet sakrifica e tyre sublime për lirinë dhe pavarësinë e vendit tonë. "Sot,

bashkë me stafin tim dhe shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së, në 22-vjetorin e rënies së heroit Mujë Krasniqi dhe 40 bashkëluftëtarëve të tij, me homazhe në Kompleksin e Dëshmorëve në Marinë përkujtuam sakrificën dhe veprën e tyre për liri dhe pavarësi, luftën e pastër të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lavdi heroit Mujë Krasniqi dhe 40 bashkëluftëtarëve të tij! Lavdi të gjithë dëshmorëve të kombit!", është shprehur Jashari.



Haziri: Figura e Agimit do të rezatojë si roje e paqes edhe në kazermën elitare të FSK-së



GJILAN, 14 DHJETOR (ER) - Në dyvjetorin e themelimit të Ushtrisë së Kosovës është zbuluar të hënën mozaiku i figurës së heroit të kombit Agim Ramadani, në një ceremoni të veçantë në regjimentin e forcave tokësore të FSK-së në Gjilan.

Kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se ndihet i lumtur që pas një ekspozeje njëvjeçare në qendër të qytetit, mozaiku me figurën e Agimit është zhvendosur në kazermën e FSK-së. "Jam i nderuar që jam sot në shpalosjen e këtij punimi në këtë kazermë elitare. Këtu ndihesh i privilegjuar dhe i sigurt për të gjitha pritet që ne i kemi pasur për shtetin, institucionin, në veçanti për pjesën ushtarake të republikës sonë. Agimi ka zbarkuar prej një ekspozeje njëvjeçare në qendër të qytetit në kazermë, aty ku e ka vendin dhe ky aty ku figura e tij të

rrezatojë çdo ditë si roje e paqes dhe si emër i cili ushtarit i jep motiv e mesazh që liria është e shtrenjtë dhe për liri shkohet deri në sakrificë", ka thënë Haziri, duke shtuar se ne të gjallëve na mbetet që ta kujtojmë, të gjunjëzohemi dhe ta respektojmë veprën e secilit. Ministri i Mbrojtjes, Anton Quni, ka thënë se heronjtë janë të pavdekshëm. "Vepra madhështore artistike e zbuluar sot e mozaikut me portretin e vëllait tim të armës dhe idealit, heroit të kombit Agim Ramadani - Katana, e punuar në mënyrë të veçantë nga kreatori ynë Besart Gashi me mbështetjen e Muhamet Ajrullahut, e konfirmon fuqishëm faktin se dëshmorët janë të pavdekshëm", ka thënë Quni.

Ndryshe mozaiku me figurën e Agim Ramadani është punuar me kapëse metali dhe ka hyrë në librin e rekordave guinness.

Stacioni i Autobusëve në Ferizaj, në gjendje të rëndë financiare

FERIZAJ, 14 DHJETOR (ER) - Stacioni i Autobusëve në Ferizaj është në gjendje të rëndë financiare, është bërë me dije të hënën në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa. Në këtë mbledhje është bërë propozim-vendimi për subvencionimin e Stacionit të Autobusëve për pagesën e pagave të punësuarve. Drejtoresha e Financave, Sebahate Ajeti-Sadiku, ka thënë se kjo po bëhet duke u mbështetur në rrethanat të

cilat janë krijuar gjatë këtij viti si pasojë e pandemisë globale Covid-19. Sipas saj, stacioni i autobusëve nuk ka arritur të realizojë të hyra të mjaftueshme për kompensimin e të ardhurave mujore të të punësuarave dhe është në gjendje të rëndë financiare. "Prandaj ne si komunë duhet ta mbështesim me subvencionimin e pagave mujore në vlerë 29 640 përmuajt nëntor dhe dhjetor të vitit 2020", është shprehur

drejtoresha Ajeti-Sadiku. Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa kanë vendosur që raporti vjetor i NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A., raporti vjetor i kompanisë "Ambientit" Sh. A. si dhe raporti vjetor i KRM "Pastërtia" për vitin 2019 të diskutohen në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po në këtë mbledhje u diskutua edhe propozim-vendimi përlirim-faljen përlukalet në pronësi të komunës.



Në spitalin e Pejës vdes një i burgosur

Prishtinë, 14 dhjetor (ER) - Shërbimi Korrektues i Kosovës ka njoftuar se të hënën rreth orës 5:45 në spitalin rajonal të Pejës ka ndërruar jetë i burgosuri M. C., viti

i lindjes 1948. I burgosuri gjatë qëndrimit në Q. K. Dubravë, është shtrirë në Repartin Psikiatrik të Spitalit Rajonal të Pejës ku, përkundër ofrimit të ndihmës mjekësore, i njëjtë

06.12.2020, me rekondit të mjekut të Q. K. Dubravë, është shtrirë në Repartin Psikiatrik të Spitalit Rajonal të Pejës ku, përkundër ofrimit të ndihmës mjekësore, i njëjtë

ka ndërruar jetë. Gjatë qëndrimit në Repartin Psikiatrik të Spitalit Rajonal të Pejës, M. C., më 10.12.2020, ishte testuar për Covid 19, me ç'rast kishte rezultuar pozitiv.

Organet kompetente janë duke i zhvilluar procedurat ligjore, ndërsa autopsia do ta verifikojë shkakun e vdekjes", ka njoftuar Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Në përvjetorin e vrasjes së civilëve serbë dhe malazezë në kafenenë "Panda" në Pejë

Kush i vrau civilët në Kosovë dhe si u përgatitën listat e civilëve të vrarë që i vishen UÇK-së?



Shkruan: Bardhyl MAHMUTI

"Papritmas, pak pas orës 20.00 dëgjova përplasje të frikshme të derës dhe pas saj, krisma armësh. Shokët e mi rrëzoheshin si duaj njëri pas tjetrit. Te dyert qëndronin dy terroristë, të veshur me të zeza, me kapela në kokë dhe pamëshirshëm gjuanin kundër nesh. Plumbi i parë e goditi Ivanin, që u rrëzua mbi mua (...)" sjell kujtimet e veta Nikola Rajoviq përmbrëmjen e 14 dhjetorit të vitit 1998 në kafenenë "Panda" në Pejë. Nga 13 persona që kishin qenë të pranishëm në kafene, që frekuentohej kryesisht nga të rinjtë malazezë dhe serbë, gjashtë persona humbën jetën: Ivan Obradoviq (14 vjeç), Vukota Gvozdenoviq (16 vjeç), Svetislav Ristiq (17 vjeç), Zoran Stanojeviq (17 vjeç), Dragan Trifoviq (17 vjeç) dhe Ivan Radeviq (25 vjeç), ndërsa tre persona u plagosën rëndë. Slavica Obradovi i, nëna e Ivanit dhe të gjitha nënët e të vrarëve të tjerë, edhe sot e kësaj dite kërkojnë ta dinë se kush i vau



dhe kush dha urdhër për vrasjen e tyre.

15 vjet më vonë, në një shkrim të datës 17 janar 2014, gazeta beogradase "Kurir" solli hollësira rreth asaj se kush qëndron konkretisht prapa këtij krimi të përbindshëm. Duke u bazuar në burimet qeveritare të Serbisë, bëhet me dije se

informatat përmasakrën në kafenenë "Panda" i kishte dhënë "ish-Shefi i Sigurimit Shtetëror serb, Radomir Markoviq". Sipas pohimeve të Radomir Markoviqit, "Milorad Ulemek-Legija" kishte organizuar likuidimin e djelmoshave serbë në kafenenë "Panda". Përballë kësaj situatë ku e vërteta filloj të dalë në shesh, "Milorad Ulemek-Legija u deklarua se është i gatshëm të dëshmojë se urdhri përm vrasjen në Pejë ka ardhur nga kreu i Shërbimit të Sigurisë Shtetërore, në krye të cilët ka qenë Rade Markoviq". Në intervistën përm gazetën "Kurir" ish-zëvendëskryeministri jugosllav Vuk Drashkoviq deklaroj: "Vendimin përm serinë e krimave kundër serbëve në Kosovë dha

shqiptarëve që e mbështetnin Serbinë dhe e dënonin UÇK-në, e solli Milosheviqi dhe Shtabi i tij strategjik. Në krye të eskadronit të vdekjes, Njësisë përm Operacione Speciale, u caktua Milorad Ulemek-Legija (...) Ky i merrte urdhrat nga Radomir Markoviq, ish-shefi i Shërbimit të Sigurimit Shtetëror të Serbisë. U vendos që Shërbimi i Sigurisë Shtetërore të kryente një varg sulmesh terroriste të cilat duhej t'i visheshin UÇK-së. Qëllimi i këtyre sulmeve ishte që UÇK-ja të paraqitej në sytë e bashkësisë ndërkombëtare si organizatë terroriste. Në të njëjtën kohë, përmes këtyre aksioneve do t'u jepoj zjarr ndjenjave antishqiptare në Kosovë dhe në tërë Serbinë (...) Në funksion të

kësaj strategie, Sigurimi Shtetëror i Serbisë, me në krye Radomir Markoviq, me ndihmën e Milorad Ulemek-Legjas, më 14 dhjetor 1998 kreu masakrën kundër gjashtë djelmoshave serbë e malazezë në kafenenë 'Panda' në Pejë".

Zbulimi i kësaj të vërtete bëri që të reagon ish-shefi i Shërbimit Sekret Serb, Radomir Markoviq, i cili ndodhet në burg përm organizimin e vrasjeve në Serbi. Në kërkësën përm falje të dënimit që i drejtoi kryetarit të Serbisë, Tomislav Nikolic, Radomir Markoviq kërcënoi se "do ta rrëzojë Serbinë në gjunjë nëse e publikon listën e krimave të bëra kundër serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë". Deklarata e njeriut që ka qenë në krye të Shërbimit Sekret të Serbisë përm listën e krimave që ky shërbim i kishte kryer kundër serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë, "LISTË QË DO TA GJUNJËZONE SERBINË", është domethënëse përmasat e krimave shtetërore kundër civilëve të të gjitha përkatësive etnike me qëllim të nxitjes së urrejtjes ndëretnike dhe stigmatizimit të UÇK-së si organizatë "terroriste".

Të gjitha atyre që u intereson të dinë më shumë rreth kësaj forme të veprimit të pushtetit serb, i ftoj të lexojnë kapitullin e dytë të pjesës së parë librit "Mashtrimi i madh" (f. 51-71), ndërkëq në faqet 526-549 do të kenë mundësi të informohen përm mënyrën se si Shërbimi Sekret i Serbisë sajoi listat e civilëve të vrarë gjatë luftës në Kosovë dhe kush është në ato lista.




<https://kosovogenocide.com/wp-content/uploads/2019/07/Bardhyl Mahmuti - Mashtrimi i madh.pdf>

Bulliqi zgjedh drejtorët e rindë

PODUJEVË, 14 DHJETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Podujevës, Shpejtum Bulliqi, ka mbajtur të hënën një konferencë përm media, në të cilën ka prezantuar përbërjen e kabinetit qeverisës. Me këtë rast kryetari Bulliqi u zotua se bashkë me ekipin qeverisës do të angazhohen shumë dhe me ndërgjegje të pastër që të punojnë në interes të të gjithë qytetarëve pa dallim. Ai ka bërë me dije se në kabinetin qeverisës ka kuadro të reja e shumë profesionale që e kanë dëshmuan veten para çdo sfide. Nënqryetare e komunës është zgjedhur Marigona Lahu; drejtor i Drejtorisë së Administratës - Bahri Selimi;

drejtor i Drejtorisë përm Buxhet dhe Financa - Fatlum Osmani; drejtor i Drejtorisë së Arsimit - Avni Fetahu; drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale - Egzona Mustafa; drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtje dhe Shpëtim - Fevzi Jetullah; drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit Ekonomik - Pajtim Balaj; drejtor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit - Elhame Kutllovic; drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit - Ajet Potera; drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtje e Mjedisit - Bujar Hasani; dhe drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Vigan Salihu.





'Nxehët' Superliga, Drita ndalet nga Arbëria

Drita nuk e ka shfrytëzuar gabimin e Ballkanit pasi të enjten ka luajtur baras me Arbërinë duke mos e shtuar dallimin e pikëve me skuadrat përcjellëse. Pa fitues përfundoi edhe ndeshja tjetër në mes të Trepçës '89 dhe Drenicës

EPOKA
ERE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Baras kanë përfunduar dy ndeshjet e javës së 18-të në Superligë. Kampionia në fuqi e Superligës, Drita e Gjilanit, është ndalur në barazim nga Arbëria (1-1). "Kemi grup mjaft cilësor dhe po paraqitemi mirë. E kemi ditur se do të jetë e vështirë pasi nuk ka ndeshje të lehta. Nuk jam i kënaqur me rezultatin, por jam i kënaqur me lojën. Kishim raste të mira shënuar. Rregulli i pashkruar i futbollit na ndodhi sot, pasi nuk shënuan në rastet që kishim e në anën tjetër pësuam. Arbëria nuk kishte asnjë rast deri në momentin e shënimit të golit", ka thënë pas ndeshjes Ardiq Nuhiu, trajner i Dritës.

Liderja aktuale, Drita, kaloi e para në epërsi në minutën e 36-të nëpërmjet Kastriot Rexhës nga penalltia. Pjesa e parë e kësaj ndeshje që u zhvillua në stadiumin "Riza Lushta" ishte interesante. Vendosit kishin dy raste të mira shënuar, por Bismark Sie i shpërdori që të dy rastet. Në anën tjetër mysafirët nuk patën ndonjë mundësi ideale për

dytë dhe të fitores, por kjo ishte e pamundur dhe ndeshja përfundoi me rezultat të barabartë 1-1. Pas kësaj ndeshje, Drita ka 40 pikë dhe vazhdon të jetë në vendin e parë, kurse Arbëria që ka befasuar disa skuadra në këtë kampionat, ngrehet në pozitën e gjashtë me 21 pikë.

Trajneri i Arbërisë, Arbnor Morina, pas ndeshjes ka deklaruar: "Jam i kënaqur me pikët që kemi fituar, por të gjithëve do të na mbetet zhig për një ose dy pikë më tepër që nuk i morëm në ndeshjet e kaluara. Jemi skuadër e re në Superligë dhe duhet të flasim me superlativë si për futbollistët, po ashtu edhe për punën në ekip, prandaj jemi të kënaqur me rezultatin e arritur". Nëndeshja tjetër që u zhvillua të enjten në mes të Trepçës '89 dhe Drenicës përfundoi baras 0-0. Pjesa e parë e kësaj ndeshje që u zhvillua në stadiumin "Riza Lushta" ishte interesante. Vendosit kishin dy raste të mira shënuar, por Bismark Sie i shpërdori që të dy rastet. Në anën tjetër mysafirët nuk patën ndonjë mundësi ideale për

shënim, përvèç disa gjysmërasteve. Vendosit edhe një pjesën e dytë kishin më shumë raste, por Bismark Sie dhe Arbnor Muja nuk shënuan. Pas kësaj ndeshje, Trepça '89 është në pozitën e shtatë me 21 pikë, ndërsa skuadra e Drenicës është në pozitën e parafundit me 19 pikë.

SUPERLIGA		
	Pikë	
Drita - Arbëria	1-1	
Trepça '89 - Drenica	0-0	
Prishtina - Ballkani	2-1	
Llapi - Feronikeli	3-2	
Besa - Gjilani	1-2	
Tabela		
1. Drita	17	40
2. Ballkani	17	38
3. Prishtina	17	31
4. Gjilani	17	26
5. Feronikeli	18	23
6. Arbëria	18	21
7. Trepça '89	18	21
8. Llapi	18	20
9. Drenica	18	19
10. Besa	18	6

SHKURT

Arteta: Gabimi i Xhakës na kushtoi

Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, ka folur përkundër kartonin e kuq që e mori mesfushori Granit Xhaka në ndeshjen ndaj Burnley. Ai ka thënë se gabimi i Xhakës i ka kushtuar skuadrës së Arsenalit me humbje. "Ai ka bërë një gabim që na ka kushtuar. Mënyra se si loja po luhej dhe dominimi që patëm tregon qartë se do të fitonim. Por, pastaj, kur jeni me 10 lojtarë, është më e lehtë përkundër kundërshtarit. Në këtë aspekt Graniti e ka kaluar limitin. Nuk mund të bëjmë kësi soj gabimesh. Është qasje e gabuar", ka thënë Arteta.

Taekwondistët e Kosovës rrëmbejnë dy medalje evropiane

Dy të bronzta është bilanci i medaljeve të fituara nga taekwondistët e rinj të Kosovës në Kampionatin Evropian përkundër që u mbajt gjatë fundjavës në Sarajevë të Bosnjë e Hercegovinës. Jon Gashi dhe Elion Agushi u ngjitën në podium, në kategoritë 61 kilogramë, përkatësisht 57 kg. Agushi imposhtoi rumunin Stefan Agrisan, ndërsa u mposht në gjysmëfinale nga Fahrudin Adiloviq i Bosnie e Hercegovinës. Gashi triumfoi ndaj polakut Mikolai Sokolowski, për t'u ndalur më pas në gjysmëfinale. Në Evropian mori pjesë edhe Orion Osek, i cili, përkundër se dha maksimumin, u mposht nga maqedonasi Andrej Vasilevski në kategorinë -41 kg.

KB Ylli ndërpreu bashkëpunimin me trajnerin Radoviq

Klubi i Superligës së Kosovës në basketboll, Golden Eagle Ylli, ka ndërprerë bashkëpunimin me trajnerin Dragan Radoviq. Ylli pësoi humbje nga Rahoveci me 20 pikë dallim, 96:76. "Pas disa rezultateve të pafavorshme për ne, klubti ka vendosur që ta ndërpresë bashkëpunimin me trajnerin Dragan Radoviq. Golden Eagle Ylli e falënderon për angazhimin dhe emocionet e dhuruara vitin e kaluar dhe i uron suksese në vazhdim", thuhet në njoftimin e klubit nga Suhareka.

Mediat spanjolle, Enriques: Kujdes nga këta dy lojtarë të Kosovës

Kualifikimet për në Kampionatin Botëror "Katar 2022" tashmë dihet se i kanë vendosur Kosovën dhe Spanjën në Grupin B dhe ballafaqimi i tyre i parë do të zhvillohet në fund të muajit mars të vitit të ardhshëm. Mediat spanjolle po u kushtojnë tashmë një vëmendje të veçantë lojtarëve të Kosovës që luajnë nëpër klubet e ndryshme evropiane. Në artikullin e fundit të publikuar nga gazeta e njohur spanjolle "Marca", i bëhet thirrje trajnerit Luis Enrique që të ketë kujdes të veçantë ndaj Valon Berishës dhe Arbëri Zenelit. "Luis Enrique dhe ekipi i tij tashmë duhet t'i analizojnë rivalët e Spanjës për t'u kualifikuar në Kupën e Botës 'Katar 2022', duke përfshirë ekipe të Kosovës", shkruan "Marca". Valon Berisha, mesfushori i Reims, është një nga lojtarët më të njohur dhe një nga kërcënimet e tyre kryesore nga ekipi i Kosovës, pa lënë pas as shokun e tij të skuadrës, Arbëri Zeneli, shkruhet më tutje. Mesfushori kosovar nga "Stade Reims" shënoi një gol të bukur këtë të diel kundër Brestit. Një gol i shkëlqyeshëm që duhet të analizohet mirë nga stafi i trajnerit të 'La Rojas', përfundon artikulli në "Marca".

Duranti rikthehet në fushë pas 18 muajsh, debuton me Brooklyn

BROOKLYN, 14 DHJETOR - Kevin Durant i shtetit e rikthyer në fushë pas një viti e gjysmë pushim si pasojë e lëndimit. Dy herë kampioni i NBA-s dhe dy herë MVP i finaleve "play-off" ka debutuar sot me fanellën e Brooklyn Netsit në fitoren që

ekipi i tij arriti ndaj Washingtonit me rezultatin 119-114, në një ndeshje miqësore. Duranti u transferua verën e kaluar te Brooklynit, por nuk luajti asnjë ndeshje. Hera e fundit që ai kishte zbritur në fushë ishte qershori

2019, kur luante me Golden State. Në këtë ndeshje ai realizoi 15 pikë. "Isha nervoz dhe kisha ankth para kësaj sfide. Kisha kohë që e prisja këtë moment, se si do të ishte debutimi im me Brooklynin", ka thënë Durant, një nga jetët e

NBA-së. "U ndjeva mirë. Pas një kohe kaq të gjatë ndihem sërisht një basketbollist. Nuk besoj se luajta shumë mirë, por rëndësi ka që u riktheva. E ndiej që në disa çaste isha solid në lojën time", ka shtuar Durant.



Barcelona - PSG, kryendeshja e Ligës së Kampionëve

NYON, 15 DHJETOR - Liga e Kampionëve mësoi të hënën çiftet e 1/16-vë dhe ka sfida mjaft interesante. Barcelona-PSG është sfida që bie në sy më shumë, me katalanosit që do ta sfidojnë ekipin që vjet doli në finale. Short i pranueshmë për kampionët në fuqi, Bayern Munch që ndeshet me Lazion e Vedat Muriqit dhe Thomas Strakoshës. Rekordmenët e Real



Shorti 1/8 e finales:

B. Monchengladbach - Man City
Lazio - Bayern Munchen
Atletico Madrid - Chelsea
Leipzig - Liverpool
Porto - Juventus
Barcelona - PSG
Atalanta - Real Madrid
Sevilla - Borussia Dortmund

Madridit sfidohen nga Atalanta, kurse Liverpooli përballet me Leipzigin. Juventusi gjeti Porton në short, kurse Manchester City gjermanët e Borussia Monchengladbach. Sevilla-Borussia Dortmund është një tjetër sfidë interesante e Champions League. Raundi i 1/16-ve është përcaktuar të luhet në datat 16-17 shkurt dhe 23-24 shkurt (ndeshjet e vajtjes), kurse më 9-10 mars dhe 16-17 mars (ndeshjet e kthimit). Të gjitha sfidat nisin në orën 21:00. Shorti për çerekfinalet dhe gjysmëfinalet hidhet më 19 mars.

Unitedi kundër Sociedadit, Arsenali përballet me Benficën

NYON, 14 DHJETOR - Në Nyon të Zvicrës është hedhur shorti i fazës së 1/16-vë të Ligës së Evropës, ku nuk kanë munguar as përballjet interesante. Pa fat Manchester Unitedi që, pas eliminimit nga Liga e Kampionëve, do të ketë një



SHORTI I LIGËS SË EVROPËS:
Wolfsberg - Tottenham
Dynamo Kyiv - Club Brugge
Real Sociedad - Manchester United
Benfica - Arsenal
Crvena Zvezda - Milan
Antwerp - Rangers
Slavia Praha - Leicester City
Salzburg - Villareal
Braga - Roma
Krasnodar - Dinamo Zagreb
Young Boys - Bayer Leverkusen
Molde - Hoffenheim
Granada - Napoli
Maccabi Tel Aviv - Shakhtar D.
Lille - Ajax
Olympiacos - PSV

provë të vështirë ndaj kryesuesve të Real Sociedadit. Milani do të jetë i impenjuar ndaj Crvena Zvezdës, skuadra serbe që gjatë verës sfidoi Tiranën në Ligën e Kampionëve, duke na eliminuar me një gol të Tomane. Arsenali ndërkohë do të ketë një duel të vështirë ndaj një ekipi me shumë përvojë në kompeticionet evropiane si Benfica, ndërkohë që Tottenhami do ta sfidojë Wolfsbergun. Takimet e para do të zhvillohen më 18 shkurt, ndërsa të kthimit më 25 shkurt. Oraret e përballjeve janë të njëjta, 18:55 dhe 21:00. Shorti përfazën e 1/16-vë do të hidhet më 26 shkurt.

Hamiltoni: Nuk i kuptoj liderët botërorë që qeshin me Covidin

Lewis Hamiltoni u kthye të garoje në fundjavën që sapo lamë në Çmimin e Madh të Abu Dhabi, i fundit për këtë sezoni. 35-vjeçari në Abu Dhabi arriti ta marrë vendin e tretë, duke kurorëzuar kështu titullin e shtatë kampion bote.

"Jam i shkatërruar fizikisht. Nuk ndihem mirë. Jam i lumtur dhe mirënjohës që jam gjallë. Nuk isha në gjendjen time optimale dhe përsëri arrita të përfundoj në podium. Covid-19 nuk është shaka. Kurrë nuk e mendova se ishte. Nuk mendova se isha i infektuar. Më pas e kuptova se do ta kisha të vështirë sepse ka njerëz që kanë humbur jetën prej koronavirusit. Më duket e çuditshme të shoh liderë botërorë duke qeshur sikur nuk është asgjë."

E dija se nuk do të isha në gjendje të mirë fizike këtë fundjavë, por e arrita. Aty ku ka vullnet, gjendet gjithmonë një mënyrë zgjidhje", ka thënë Hamiltoni. "Ishte një nga vitet më të vështirë, për të mos thënë më i vështiri. Planifikoj të

jem te Mercedes vitin e ardhshëm. Dua të jem këtu. Kemi për të bërë ende bashkë si në Formula 1 dhe jashtë saj. Shpresoj që shpejt të nisin diskutimet përinovimin dhe ta arrjmë atë para Krishtlindjeve", u shpreh Hamiltoni.

SHKURT

Haaland: Bayerni është skuadra më e mirë në botë

Sulmuesi i Borussia Dortmundit, Erling Haaland, ka thënë se aktualisht Bayern Munchen është skuadra më e fortë në botë. "Fitimi i Ligës së Kampionëve është padishim një èndërr e imja e madhe. Unë dua të fitoj trofe me Dortmundin. Tani për tanin, Bayern Munchen është skuadra më e mirë në botë dhe ne duhet të përpinqemi të arrjmë një nivel më të lartë, ta mundim atë. Do të përpinqemi me të gjitha forcat tona", ka thënë Haaland.

PSG-ja: Brenda 48 orëve do t'i bëhet edhe ekzaminim lëndimit të Neymarit

Paris-Saint Germaini përmes një komunikate të publikuar në faqen e vet, ka treguar gjendjen e sulmuesit Neymar. Brazilianni doli nga fusha me dhimbje dhe duke qarë, në ndeshjen ndaj Lyonit. Thiago Mendes, i cili ndërhyri në brazilianin, u përjashtua nga loja me karton të kuq. Pas një analize nga VAR u pa se ndërhyrja ishte më e vrazhdë sesa që mendohej. "Ekzaminimet mjekësore të kryera në Neymar Jr janë premtuese, pas kyçit të këmbës së tij të shtrembëruar në ndeshjen e së dielës kundër Lyonit. Ekzaminimet e mëtejshme do të kryhen në 48 orë", thuhet në njofrimin e PSG-së.

Interi dhe Juventus, në garë për Felixin

Talenti i Atletico Madridit, Joao Felix, nuk ndihet i lumtur në Madrid. Pasi u irritua pa masë teksa u zëvendësua në derbin ndaj Real Madridit. "Calciomercato" shkruan se Interi dhe Juventusi po e ndjekin me vëmendje 21-vjeçarin portugez, madje janë gati t'i "sakrifikojnë" dy jetët e skuadrave për "xhevahirin" e Atleticos. "Zikaltrit" janë të gatshëm të ofrojnë Lautaro Martinezin, ndërsa kampionët në fuqi të Italisë pranojnë të jepin "dhuratë" Paulo Dybalën. Felix nuk po konsolidon dot marrëdhënien me trajnerin Simeone dhe fakti që konsiderohet një yll i ardhshëm i futbollit evropian ka bërë që shumë klube të mëdha të interesohen për të.

Ndërroi jetë ish-trajneri i Liverpoolit, Gerard Houllier

Një tjetër lajm i trishtë vjen këtë herë nga Franca. Pas Otto Bariçit, një tjetër trajner i famshëm humbet jetën. Ish-tekniku francez Gerard Houllier vdiq mëngjesin e sotëm në moshën 73-vjeçare. Lajmi u konfirmua nga mediat franceze. Nuk dihen ende shkaqet e vdekjes së tij, por së fundmi ai u operua në Paris nga zemra. Houllier drejtoi gjatë karrierës PSG-në, Lyonin, Liverpoolin, Francën etj. Suksesin më të madh e arriti me "Té kuqtë" në vitet 2001-2003 duke fituar Kupën UEFA dhe Superkupën e Evropës. Gjatë jetës së tij ai vuante nga problemet në zemër. Në vitin 2001 ai pësoi infarkt në ndeshjen e Premierë Ligës ndaj Leeds Unitedit. Nuk kanë munguar mesazhet e ngushëllimit përfamiljarët nga klubet të cilët Houllier ka drejtuar për ndarjen e tij ngajeta.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

KRYETARI I KOMUNËS

1 Nr.464-37927
Datë: 14.12.2020

Në bazë të dispozitave të neneve 11,13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28 datë 4 Qershor 2008, nenit 4 dhe nenit 11 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/1-205 datë 28 Tetor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91), të dispozitave të nenit 83 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 datë 25 Maj 2016, nenit 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 datë 26.09.2008, Vendimit të Kuvendit Komunal Lipjan 15Nr.464-26331 datë 29.06.2020 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive në funksion të ndërtimit të rrugës unazore në Lipjan, Kryetari i Komunës së Lipjanit merr:

VENDIM PËRFUNDIMTAR

I. MIRATOHET shpronësimi i pronave të paluajtshme në Zonën Kadastrale Lipjan, sipas Listës së bashkangjitur të këtij Vendimi për arritjen e qëllimit dhe përsfritimit të ligjshëm publik për riplanifikim i trasesë pjesa që ndërliqdhë rrugën ekzistuese "Bajram Gashi", "Sadik Shala" dhe pjesa e segmentit rrugor "Halil Metaj" si fazë e parë implementuese në Lipjan, me Vendimin e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Lipjanit 15Nr.464-26331 datë 29.06.2020 për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive në funksion të ndërtimit të rrugës unazore në Lipjan.

II. Obligohet Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik që brenda pesë (5) ditëve të punës t'iu dërgojë Vendimin Përfundimtar personave të identifikuar në këtë Vendim.

III. Pjesë e këtij Vendimi është akti i vlerësimit në të cilin është përcaktuar shuma e kompensimit për ata Pronar apo Zotërues të Interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të të cilëve janë prekur nga procesi i shpronësimit.

IV. Nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, obligohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa, që brenda afatit prej dy (2) viteve të paguaj plotësisht shumën e kompensimit të pronës së shpronësuar të përcaktuar sipas raportit të vlerësimit të Zyrës për Vlerësimin e Pronës së Paluaqitshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës.

V. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të Vendimit Përfundimtar, Zyra e Kryetarit e shpall Vendimin në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Page 1 of 7

VI. Kundër këtij Vendimi brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas hyrjes në fuqi të tij, kanë të drejtë të paraqesin ankesë në Gjykatën Themelore Prishtinë-dega në Lipjan çdo person i cili është Pronar ose Zotëruesh i Inerisit në pronën ose të drejtat pronësore të prekura nga Vendimi Përfundimtar, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes të drejtëpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme, pavarësisht nescësështë identifikuar apo jo në vendim, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit në përputhje me nenet 36 dhc 37 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet me Ligjin Nr.03/I-205 datë 28 Totor 2010 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.91).

VII. Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-Sektori pronësoro-juridik, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Shërbime Publike.

IX. Vendimi Përfundimtar hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe publikimit të tij në njërrën nga gazetat me tirazh më të madh në Kosovë.

Iu dërgohet:

- Pronarëve ose Zotëruçsëve të Interesit
 - Drejtorati për Urbanizëm Planifikim dhe Mbrotje të Mjedisit
 - Drejtorati për Buxhet dhe Financa
 - Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër
 - Drejtorati për Shërbime Publike

A circular blue ink stamp. The outer ring contains the text "KRYETARI I KOMUNËS" at the top and "IMRI AHMETI" at the bottom. The inner circle contains the text "LIPJAN" at the top, "KOSOVO" at the bottom, and "REPUBLIKË" on the left. There is also a small number "1" near the center.

Pershkrimi detaj i parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njësisë kadastrale për shpronësim për rrugën e re në Lipjan								
K.K. Lipjan				K.K. Lipjan				
Gjendja e vjetër				Gjendja e re				
Nr.	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe e mbetur m ²
1	Ilir Zeqiri (Rasim)	00637-12 ZK Lipjan	Livadh i kl.1	800	Gjerëtanishmi	E re		645
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	155
2	Rruzhdi Gashi	00637-9 ZK Lipjan	Livadh i kl.1	370	Gjerëtanishmi	E re		355
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	15
3	Rruzhdi Gashi	00671-10 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	80	Gjerëtanishmi	E re		72
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	8
4	Luminije Kongjeli (Halit)	00671-11 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	670	Gjerëtanishmi	E re		611
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	59
5	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	02082-1 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	400	Gjerëtanishmi	E re		378
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	22
6	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	02082-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	400	Gjerëtanishmi	E re		379
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	21
7	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	02082-3 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	400	Gjerëtanishmi	E re		379
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	21
8	Avni Bytyqi (Ibrahim)	02082-4 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	500	Gjerëtanishmi	E re		473
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	27
9	Isuf Bytyqi (Ibrahim)	02082-5 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	500	Gjerëtanishmi	E re		473
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	27
10	Sami Bytyqi	02082-6 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	400	Gjerëtanishmi	E re		378
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	22
11	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	02082-7 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	300	Gjerëtanishmi	E re		282
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	18
12	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	02082-8 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	400	Gjerëtanishmi	E re		375
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	25
13	Suzana Vehapi	00671-9 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	610	Gjerëtanishmi	E re		570
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	40
14	Fevzi Reçica (Idriz)	00672-2 ZK Lipjan	Arë e kl.3	2471	Gjerëtanishmi	E re		2432
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	39
15	Hasim Vishesella (Jahir)	00672-3 ZK Lipjan	Arë e kl.3	3272	Gjerëtanishmi	E re		3003
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	269
16	Fevzi Reçica (Idriz)	00672-4 ZK Lipjan	Arë e kl.3	1529	Gjerëtanishmi	E re		1407
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	122
17	Sefa Bajrami (Shirë)	00674-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	590	Gjerëtanishmi	E re		242
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	348
18	Xhezair Bajrami (T)	01406-1 ZK Lipjan	Arë e kl.2	1132	Gjerëtanishmi	E re		759
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	373
19	Habib Sadiku	01407-2 ZK Lipjan	Arë e kl.2	1971	Gjerëtanishmi	E re		1567
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	385
20	Habib Sadiku	00440-14 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	1719	Gjerëtanishmi	E re		1386
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	333
21	Mehdi Bajrami (Hafit)	00442-1 ZK Lipjan	Arë e kl.3	4195	Gjerëtanishmi	E re		2742
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	1453
22	Tahir Bajrami (Xhemajli)	00459-0 ZK Lipjan	Arë e kl.3	7944	Gjerëtanishmi	E re		6597
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	1347
23	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	00671-6 ZK Lipjan	Rrugë private	73	Gjerëtanishmi	E re	-	-
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	73
24	Hasim Vishesella (Jahir)	00671-7 ZK Lipjan	Rrugë private	87	Gjerëtanishmi	E re	--	87
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	87
25	Bajram Gashi (Sabit)	00460-6 ZK Lipjan	Rrugë	680	Gjerëtanishmi	E re	--	680
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	680
26	Mejreme Jashanica (Osman)	00460-1 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	500	Gjerëtanishmi	E re		488
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	12
27	Ilfat Osmani (Ali)	00460-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	770	Gjerëtanishmi	E re		724
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	46
28	Izet Osmai (Ali)	00460-3 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	770	Gjerëtanishmi	E re		725
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	45
29	Brahim Bytyqi	00460-4 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	600	Gjerëtanishmi	E re		566
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	34
30	Tahir Bajrami	00460-5 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	710	Gjerëtanishmi	E re		631
					Komuna e Lipjanit	KK Lipjan	Rrugë lokale	79
31	Stefan Simeonoviç (Zlatibor)	00462-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	6030	Gjerëtanishmi	E Re		5276
					Komuna e Lipjanit		Rrugë lokale	754
32	Mexhid Mustafa (Jetullah)	00615-11 ZK Lipjan	Arë e kl.3	4176	Gjerëtanishmi	E Re		3782
					Komuna e Lipjanit		Rrugë lokale	394
33	Braim Bajraktari (Shaqir)	00615-12 ZK Lipjan	Arë e kl.3	2000	Gjerëtanishmi	E Re		1881
					Komuna e Lipjanit		Rrugë lokale	119
34	Visar Olluri (Hamit)	00615-10	Arë e kl.3	600	Gjerëtanishmi	E Re		563

	Fatos Olluri	ZK Lipjan		Komuna e Lipjanit	Rrugë lokale	37
35	Sabri Tasholli (Sylejman)	00615-7 ZK Lipjan	Arë e kl.3	800	Gjerëtanishmi E Re	739
				Komuna e Lipjanit	Rrugë lokale	61
36	Hysni Zogaj (Sokol)	02100-8 ZK Lipjan	Arë e kl.3	500	Gjerëtanishmi E Re	485
				Komuna e Lipjanit	Rrugë lokale	15
37	Fidaim Fazlija (Xhezahir)	02100-6 ZK Lipjan	Arë e kl.3	898	Gjerëtanishmi E Re	618
				Komuna e Lipjanit	Rrugë lokale	280
38	Fidaim Fazlija (Xhezahir)	02100-18 ZK Lipjan	Arë e kl.3	440	Gjerëtanishmi E Re	416
				Komuna e Lipjanit	Rrugë lokale	24
39	Fidaim Fazlija (Xhezahir)	02100-17 ZK Lipjan	Arë e kl.3	440	Gjerëtanishmi E Re	421
				Komuna e Lipjanit	Rrugë lokale	19
40	Fidaim Fazlija (Xhezahir)	02100-16 ZK Lipjan	Arë e kl.3	440	Gjerëtanishmi E Re	433
				Komuna e Lipjanit	Rrugë lokale	7
41	Burim Mziu	02100-3 ZK Lipjan	Arë e kl.3	5494	Gjerëtanishmi E Re	5205
				Komuna e Lipjanit	Rrugë lokale	289

Përshkrimi detaj i parcelave kadastrale sipas Certifikatës-Njësisë kadastrale për shpronçsim për rrugën Halil Metaj në Lipjan

K.K. Lipjan			K.K. Lipjan							
Gjendja e vjetër			Gjendja e re							
Nr.	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe m ²	Pronar	Parcela kadastrale	Kultura-klasa	Sipërfaqe e mbetur m ²	Sipërfaqe përrugë m ²	
1	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00628-6 ZK Lipjan	Arë e kl.3	59	Gjerëtanishmi E Re		--			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				59		
2	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00644-0 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	2439	Gjerëtanishmi E Re		2231			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				208		
3	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00645-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	1770	Gjerëtanishmi E Re		1049			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				721		
4	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00643-0 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	2289	Gjerëtanishmi E Re		2115			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				174		
5	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00642-1 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	1180	Gjerëtanishmi E Re		1143			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				37		
6	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00642-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	1120	Gjerëtanishmi E Re		1063			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				57		
7	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00641-0 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	2335	Gjerëtanishmi E Re		2287			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				48		
8	Haxhi Sinani (Hasan)	00640-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	500	Gjerëtanishmi E Re		477			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				23		
9	Trajkoviq Qedomir (Trifk)	00637-7 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	1154	Gjerëtanishmi E Re		1141			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				13		
10	Muhamed Krasniqi	00638-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	2381	Gjerëtanishmi E Re		2360			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				21		
11	Jakup Bytyqi (Ahmet)	00637-5 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	1300	Gjerëtanishmi E Re		1295			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				5		
12	Ramadan Bytyqi (Ahmet)	00637-1 ZK Lipjan	oborr	1000	Gjerëtanishmi E Re		973			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				27		
13	Ramadan Bytyqi (Ahmet)	02189-0 ZK Lipjan	Livadh i kl.1	593	Gjerëtanishmi E Re		563			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				30		
14	Shaban Gashi	00464-0 ZK Lipjan	Arë e kl.3	3289	Gjerëtanishmi E Re		2939			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				350		
15	Samir Pacolli (Hisen)	00467-2 ZK Lipjan	Arë e kl.3	839	Gjerëtanishmi E Re		740			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				99		
16	Afrim Thaqi (Ali)	00628-5 ZK Lipjan	Arë e kl.3	88	Gjerëtanishmi E Re		...			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				88		
17	Hetem Bytyqi (Baki)	00761-5 ZK Lipjan	Arë e kl.2	1499	Gjerëtanishmi E Re		1491			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				8		
18	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00628-4 ZK Lipjan	Arë e kl.1	73	Gjerëtanishmi E Re		34			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				39		
19	Qazim Gashi (Sahit)	02121-2 ZK Lipjan	Arë e kl.2	391	Gjerëtanishmi E Re		371			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				20		
20	Isni Rama (Sali)	00627-5 ZK Lipjan	Arë e kl.3	400	Gjerëtanishmi E Re		379			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				21		
21	Xhevdev Dubova (Ramadan)	00627-6 ZK Lipjan	Arë e kl.3	415	Gjerëtanishmi E Re		381			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				34		
22	Muharem Gérxhaliu	00627-7 ZK Lipjan	Arë e kl.3	400	Gjerëtanishmi E Re		356			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				44		
23	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00627-8 ZK Lipjan	Arë e kl.3	5274	Gjerëtanishmi E Re		4669			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				605		
24	Zhivorad Radiq (Petar), Zorica Markovic (Voislav), Fatmir Limani (Hamit)	00629-0 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	45	Gjerëtanishmi E Re		...			
				Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale				45		

25	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00630-0 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	40	Gjerëtanishmi E Re		...		40
26	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00631-1 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	28	Gjerëtanishmi E Re		...		28
27	Blerim Ibrahimim (Rasim)	00631-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	28	Gjerëtanishmi E Re		...		28
28	Jova Bogunovic (Nikole)	00632-0 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	100	Gjerëtanishmi E Re		...		

					Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale			100
29	Jova Bogunovic (Nikole)	00633-0 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	40	Gjerëtanishmi E Re		...	40
30	Qedomir Trajkovic (Trifk)	00634-0 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	25	Gjerëtanishmi E Re		...	25
31	Mustaf Hajrullahi (Hamdi) Slavkoja Kostiq	00635-0 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	95	Gjerëtanishmi E Re		..	95
32	Sabri Tasholli (Sylejman)	00615-8 ZK Lipjan	Arë e kl.3	1200	Gjerëtanishmi E Re		964	
					Komuna e KK Lipjan Rrugë lokale			236
33	Banush Fazliu	00613-3 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	120	Gjerëtanishmi E Re		...	120
34	Branislav Trajkovic (Stojana)	00613-2 ZK Lipjan	Livadh i kl.2	90	Gjerëtanishmi E Re		..	90

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

PREDSEDNIK OPŠTINE

IBr.464-37927
Dana:14.12.2020

Na osnovi stavova č

VII. Protiv ove Odluke unutar trideset (30) kalendarskih dana nakon stupanja na snazi, imaju pravo da podnesu žalbu u Osnovni Sud Priština-ogranak Lipjan svako lice je vlasnik ili vlasnik interesa ili pravo vlasništvo dodatnute, kao svako zainteresovano lice ima neki direktni materialni interes u nepokretnu imovinu, nezavisno ako nije identifikovan ili ne u Odluci, za protivljenju iznos kompenzacije u skladu sa članom 36 i 37 Zakona Br.03/L-139 za Ekspropriaciju Nepokretne Imovine sa dopunama i promenama Zakona Br.03/1-205 dt.28 Oktobar 2010 (Službene Novine Republike Kosova Br.91).

VIII. Za sprovođenje ove Odluke obavezuje se kancelarija Predsednika-Pravno imovinski Sektor, Direktorat Planiranje, Urbanizma i Zaštite Sredine, Direktorat za Budžet i Financije, Direktorat Geodezije i Katastar i Direktorat javnih Usluga.

VIII. Ova Odluka zajedno sa tabelarnim i grafičkim deom predstavlja pravni osnov za upisivanje u katastarskim knjigama na ime novih vlasnika tehničke podele katastarskoih parcela. Sa stapanjem na snazi ove Odluke, Direktorat za Geodeziju i Katastar je obavezan da obavlja proceduralne i tehničke postupke za njegovo sprovođenje.

IX. Završna Odluka stupa na snazi dana objavljinjanja u Službene Novine Republike Kosova i objavljinjanju u neku novinu sa većim tiražom.

Dostaviti:

- Vlasnicima i posedovniocima interesa
- Direktoratu Planiranja Urbanizma i zaštite Sredine
- Direktoratu za Budžet i Financije
- Direktoratu Geodezije i Katastra
- Direktoratu Javnih Usluga
- Arhivi Opštine



				Lipjan		Put	
17	Sefa Bajrami (Shire)	00674-2 ZK Lipjan	Livada 2 klase	590	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	242 348
18	Xhezair Bajrami (T)	01406-1 ZK Lipjan	Njiva 2 klase	1132	Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	759 373
19	Habib Sadiku	01407-2 ZK Lipjan	Njiva 2 klase	1971	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	1567 385
20	Habib Sadiku	00440-14 ZK Lipjan	Livada 2 klase	1719	S.O. Lipjan	S.O. Lipjan Lokalni Put	1386 333
21	Mehdi Bajrami (Hafir)	00442-1 ZK Lipjan	Arë e kl.3	4195	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	2742 1453
22	Tahir Bajrami (Xhemaj)	00459-0 ZK Lipjan	Njiva 3 klase	7944	Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	6597 1347
23	Ramiz Bytyqi (Ibrahim)	00671-6 ZK Lipjan	Put	73	Dosadašnji	S.O. Lipjan Kultura-klasa	73
24	Hasim Vishesella (Jahir)	00671-7 ZK Lipjan	Put	87	Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	** 87
25	Bajram Gashi (Sabit)	00460-6 ZK Lipjan	Put	680	Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	**** 680
26	Mejreme Jashanica (Osman)	00460-1 ZK Lipjan	Livada 2 klase	500	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	488 12
27	Ilfat Osmani (Ali)	00460-2 ZK Lipjan	Livada 2 klase	770	Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	724 46
28	Izet Osmai (Ali)	00460-3 ZK Lipjan	Livada 2 klase	770	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	725 45
29	Brahim Bytyqi	00460-4 ZK Lipjan	Livada 2 klase	600	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	566 34
30	Tahir Bajrami	00460-5 ZK Lipjan	Livada 2 klase	710	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	631 79
31	Stefan Simeonovic (Zlatibor)	00462-2 ZK Lipjan	Livada 2 klase	6030	Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	5276 754
32	Mexhid Mustafa (Jetullah)	00615-11 ZK Lipjan	Njiva 3 klase	4176	Dosadašnji Opština Lipjan	Novo Lokalni Put	3782 394

33	Braim Bajraktari (Shaqir)	00615-12 ZK Lipjan	Njiva 3 klase	2000	Opština Lipjan Dosadašnji	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	1881 119
34	Visar Olluri (Hamit) Fatos Olluri	00615-10 ZK Lipjan	Njiva 3 klase	600	Opština Lipjan Dosadašnji	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	563 37
35	Sabri Tasholli (Sylejman)	00615-7 ZK Lipjan	Njiva 3 klase	800	Opština Lipjan Dosadašnji	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	739 61
36	Hysni Zogaj (Sokol)	02100-8 ZK Lipjan	Njiva 3 klase	500	Opština Lipjan Dosadašnji	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	485 15
37	Fidaim Fazlija (Xhezahir)	02100-6 ZK Lipjan	Njiva 3 klase	898	Opština Lipjan Dosadašnji	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	618 280
38	Fidaim Fazlija (Xhezahir)	02100-18 ZK Lipjan	Njiva 3 klase	440	Opština Lipjan Dosadašnji	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	416 24
39	Fidaim Fazlija (Xhezahir)	02100-17 ZK Lipjan	Njiva 3 klase	440	Opština Lipjan Dosadašnji	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	421 19
40	Fidaim Fazlija (Xhezahir)	02100-16 ZK Lipjan	Njiva 3 klase	440	Opština Lipjan Dosadašnji	Novo S.O. Lipjan	Lokalni Put	433 7
